



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIQA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
OSNOVNI SUD U PRIZRENU - BASIC COURT OF PRIZREN

AD-GJTHPZ.nr.12/24

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Kryetarja e gjykatës Shpresa Emra, duke vepruar sipas kërkesës për inicim të procedurës disiplinore të parashtruar nga ana e ankuesit H.B., nga Prizreni, respektivisht të përfaqësueses së tij av.A.M., nga Prizreni, ndaj gjyqtares A.S., gjyqtare në Gjykatën Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda, lidhur me veprimet dhe sjelljen e gjyqtares sipas lëndës penale Ppr.Kr.nr.64/24, në bazë të së cilës është bërë inicimi i procedurës disiplinore, me dt.30.09.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e ankuesit H.B., nga Prizreni, respektivisht të përfaqësueses së tij av.A.M., nga Prizreni, ndaj gjyqtares A.S., gjyqtare në Gjykatën Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda, lidhur me veprimet dhe sjelljen e gjyqtares sipas lëndës penale Ppr.Kr.nr.64/24.

A r s y e t i m

Parashtruesi i ankesës H.B., nga Prizreni, respektivisht përfaqësuesja e tij av.A.M., nga Prizreni me datë 19.08.2024 pranë Këshillit Gjyqësor të Kosovës kanë parashtruar kërkesë për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtares A.S., gjyqtare në Gjykatën Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda, lidhur me veprimet dhe sjelljen e gjyqtares sipas lëndës penale Ppr.Kr.nr.64/24. Kjo kërkesë përmes KGJK-së me datë 06.09.2024 është përcjellë në Gjykatën Themelore në Prizren.

Ankuesja av.A.M., nga Prizreni në kërkesën e paraqitur ka deklaruar se, gjatë zhvillimit dhe drejtimit të procedurës gjyqësore, në dyshim të bazuar kryejnë shkelje nga neni 4 pavarësia dhe paanshmëria e gjykatave, neni 7 qasja në gjykata të Ligjit për gjykatat, neni 5 shkeljet disiplinore për gjyqtarë të Ligjit për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtareve dhe prokurorëve, neni 5 gjykimi i drejtë, i paanshëm dhe në afat të arsyeshëm, neni 7 detyrimi i përgjithshëm për vërtetimin e plotë dhe të saktë të fakteve, neni 8 parimi i pavarësisë së gjykatës, neni 9 barazia e palëve dhe neni 310 koha për përfundimin e shqyrtimit gjyqësor të KPPRK-së. Kërkojnë një gjykim të përgjegjshëm, demokratik dhe transparent në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet e kërkuara nga institucionet përgjegjëse gjyqësore me qëllim të ofrimit të mbrojtjes efikase të palës. Me propozim që ndaj zyrtarëve përgjegjës të

gjykatës Themelore në Prizren, të ndërmerren masa parandaluese të mbrojtjes për shkak të mos transparencës, me rastin e mohimit të drejtave të palës së pandehur të garantuara me kushtetutë dhe ligj. Në rastin konkret ndaj të pandehurit H.B., zhvillohet procedura hetimore në drejtim të veprës penale mosdhënia e ndihmës dhe moslajmërimi i veprës penale, i cili tani gjendet në masën e paraburgimit. Mbrojtësi i të pandehurit H.B.:, pranë Gjykatës Themelore në Prizren në rastin penal Ppr.nr.64/24, në bazë të nenit 189 par. 1, par.2, par.3, par.4 nënpar.4.1 dhe 4.2, par.5 nënpar.5. 1, 5.2, 5.3 dhe 5.4, par.6 dhe par.7 të KPPRK-së, ka ushtruar ankesë mbi ligjshmërinë e paraburgimit, e deponuar në gjykatë me date 15.07.2024, krahas urgjencës po ashtu të deponuar me gjykatë me datë 05.08.2024 ende deri më sot nga gjykata nuk është mbajtur seanca dëgjimore sipas ankesës mbi ligjshmërinë e paraburgimit, por të pandehurit i vazhdohet masa e paraburgimit pa ndonjë arsye dhe krahas ekzistimit të ankesës së parashtruar mbi ligjshmërinë e paraburgimit, me ç'rast gjykata ka shkelur nenin 189 pika 8 të KPPRK-së, në dëm të palës.

Autoriteti kompetent - Kryetarja e gjykatës pasi që ka pranuar ankesë ndaj A.S., gjyqtare në Gjykatën Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda, lidhur me veprimet dhe sjelljen e gjyqtares sipas lëndës penale Ppr.Kr.nr.64/24, ka iniciuar hetimet preliminare për procedure disiplinore dhe ka ndërmarrë disa veprime në këtë drejtim. Fillimisht ka bërë shikimin në ankesën e parashtruar, ka kërkuar deklaratë nga gjyqtarja e çështjes si dhe ka bërë shikimin e shkresave të lëndës penale Ppr.Kr.nr.64/24.

Gjyqtarja në deklaratën e saj lidhur e pretendimet e ankuesit ka cekur se si gjyqtare e procedurës paraprake lëndën Ppr.nr.64/2024 e ka pranuar me date 09.07.2024. PO me të njëjtë datë është mbajtur seanca e dëgjimit në lidhje me kërkesën e Prokurorisë Themelore — Departamenti për Krime të Rënda për caktimin e masës së paraburgimit kundër të pandehurve, gjykata ka marrë aktvendim dhe ndaj të pandehurve E.A., dhe H.B., iu ka caktuar masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej 30 ditëve duke e llogaritur nga data 07.07.2024 deri me date 07.08.2024. Me datë 10.07.2024 mbrojtësi i të pandehurit E.A., avokati A.A., ka parashtruar ankesë kundër vendimit mbi caktimin e paraburgimit, po ashtu edhe mbrojtësja e të pandehurit H.B., avokatja A.M., me date 10.07.2024 ka parashtruar ankesë. E njëjta thekson se me datë 15.07.2024 avokatja A.M., ka parashtruar ankesë mbi ligjshmërinë e paraburgimit, gjyqtarit të procedurës paraprake dhe kryetarit të gjykatës. Më 16.07.2024 Gjykata e Apelit e Kosovës me aktvendimin PN. I .DKR.Nr.628/2024 ka refuzuar si të pabazuara ankesat e avokatit mbrojtës A.A., dhe A.M., dhe e ka vërtetuar aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prizren — Departamenti për Krime të Rënda, Ppr.Kr.nr.64/2024 të datës 09.07.2024. Me date 30.07.2024 Prokuroria Themelore në Prizren — Departamenti për Krime të Rënda ka parashtruar kërkesë për vazhdimin e masës së paraburgimit ndaj të pandehurve E.A., dhe H.B., dhe gjykata me datën 06.08.2024 ju ka vazhduar masën e paraburgimit të pandehurve të lartcekur. Kundër këtij aktvendimi me datën 09.08.2024 ka parashtruar ankesë avokati mbrojtës i të pandehurit E.A., avokat A.A.:. Gjykata e Apelit të Kosovës me aktvendimin PN.I.DKR.nr.813/2024 të datës 16.08.2024 e ka refuzuar ankesën si të pabazë dhe e ka vërtetuar aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prizren — Departamenti për Krime të Rënda, Ppr.Kr.nr.64/2024 të datës 06.08.2024. Me datën 05.08.2024 avokatja mbrojtëse A.M., ka parashtruar urgjencë gjyqtarit të procedurës paraprake dhe kryetarit të Gjykatës Themelore në Prizren që të vendoset në lidhje me ankesën mbi ligjshmërinë e paraburgimit. Me datën 22.08.2024 gjyqtarja e procedurës paraprake me shkresë e ka njoftuar avokaten mbrojtëse se deri në këtë fazë asgjë nuk ka ndryshuar lidhur me pretendimet e mbrojtjes për ndërprerjen e paraburgimit. Me datën

03.09.2024 Prokuroria Themelore në Prizren –Departamenti per Krime të Rënda, ka parashtruar kërkesë për vazhdimin e masës së paraburgimit, me q'rast kjo gjykatë me datën 05.09.2024 ka marr aktvendim dhe të pandehurve ju ka vazhduar masën e paraburgimit edhe për një muaj deri me datën 08.10.2024. Avokatja mbrojtëse A.M., me datë 09.09.2024 ka parashtruar ankesë kundër aktvendimit për vazhdimin e masës së paraburgimit dhe se me datë 12.09.2024 ankesa i është përcjellë Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Sa i përket kërkesës së avokates mbrojtëse për mbajtjen e seancës për vlerësimin e ligjshmërisë së paraburgimit nën 189 par.4 i KPPRK-së parasheh se: nëse i pandehuri ankohet për ligjshmërinë e paraburgimit, gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të zbatojë seancë dëgjimore në pajtim me nenin 185 par.3, 4, 5 dhe 6 të KPP nëse në shikim të parë me ankesë vërtetohet se arsyet për paraburgim nga nenin 184 të KPP që nga vendimi i fundit gjyqësor për paraburgim pushojnë së ekzistuari për shkak të ndryshimit të rrethanave ose zbulimit të fakteve të reja ose ndalimi për ndonjë arsye tjetër është i kundërligjshëm. Në rastin konkret rrjedhë se dispozita e lartcekur nuk është e natyrës obligative, që do të thotë se ia len në diskrecion gjyqtarit që të vendos se a do të zbatojë seancë dëgjimore apo jo. Në rastin konkret gjyqtarja e procedurës paraprake ka vlerësuar se nuk janë përmbushur asnjë nga rrethanat e nenit 189 par.4 pika 4.1 dhe 4.2 të KPP që të mbajë seancë dëgjimore dhe që eventualisht të pandehurit H.B.; t'ia ndërprejë masën e paraburgimit pasi që nga vendimi i fundit gjyqësor nuk kanë pushuar së ekzistuari arsyet apo nuk ka ndryshuar asnjë rrethanë për çka është caktuar — vazhduar masa e paraburgimit dhe ndalimi në rastin konkret nuk është i kundërligjshëm. Bazuar në të lartcekurat dhe gjyqtarja e procedurës paraprake nuk ka mbajtur seancë dëgjimore sipas kërkesës së avokates mbrojtëse. Kjo aq me tepër që edhe Gjykata e Apelit duke vendosur në bazë të ankesave të dy avokateve mbrojtës, ka marr aktvendim dhe ka vërtetuar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë — aktvendimet e lartcekura të Gjykatës së Apelit. Bazuar në të lartcekurat konsideron se si gjyqtare i ka kryer detyrat e punës në këtë çështje penale në harmoni të plotë me ligjin dhe se nuk qëndrojnë pretendimet në kërkesë kinse për shkelje të Ligjit për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, respektivisht nenit 5, në të cilin thirret avokatja mbrojtëse, nga fakti se e tërë procedura penale është zhvilluar — zhvillohet në harmoni me ligjin.

Autoriteti kompetent - Kryetarja e gjykatës pasi që ka pranuar deklaratën nga gjyqtari e çështjes, ka bërë verifikimin e shkresave të lëndës Ppr.Kr.nr.64/24.

Pas vlerësimit dhe analizës së tërësishme të provave të mbledhura Autoriteti Kompetent konsideron se:

Ankesa është e pabazuar.

Autoriteti kompetent - Kryetarja pas verifikimit të gjithë dokumentacionit ka vërtetuar gjendjen faktike si vijon:

Në Gjykatën Themelore në Prizren — Departamenti për Krime të Rënda, me datë 08.07.2024 është pranuar aktvendimi për fillim të hetimeve se bashku me kërkesën për caktim të paraburgimit nga Prokuroria Themelore në Prizren — Departamenti për Krime të Rënda, ndaj të pandehurve E.A., për shkak të veprës penale lëndim i rëndë trupor nga nenin 186 par.5 lidhur me par.3 pika 3.2 lidhur me par.2 pika 2.1 të KPRK-së dhe H.B.; për shkak të veprës penale mosdhënia e ndihmës nga nenin 188 par.4 lidhur me par. 1 të KPRK-së dhe veprës penale moslajmërimi i veprave penale apo kryesve të tyre nga nenin 378 par.1 pika 1.3 të KPRK-së.

Gjykata, pas pranimit të kërkesës menjëherë ka caktuar seancën dëgjimore përkitazi me masën e paraburgimit, ku pas kësaj ka marrë aktvendim për caktimin e masës së paraburgimit nda dy të pandehurve në kohëzgjatje prej 30 (tridhjetë) ditëve. Ndaj këtij aktvendimi, mbrojtësit e të pandehurve av.A.A., dhe av.A.M., me datë 10.07.2024 kanë ushtruar ankesë. Po ashtu, me date 15.07.2024 av.A.M., ka ushtruar ankesë mbi ligjshmërinë e paraburgimit ndaj aktvendimit të datës 09.07.2024. Gjykata, ankesën mbi ligjshmërinë e paraburgimit e ka trajtuar si kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe si të tillë e ka dërguar në Gjykatën Supreme për trajtim të mëtuftjeshëm por Gjykata Supreme e Kosovës me datë 25.07.2024 me aktin PML.nr.460/2024 e ka kthyer lëndën përsëri në gjykatën e shkallës së parë, duke theksuar se mbrojtësi të pandehurit ka ushtruar ankesë mbi ligjshmërinë e paraburgimit dhe i është drejtuar gjyqtarit të procedurës paraprake — kryetarit të gjykatës. Gjykata e Apelit me aktvendimin PNI.DKR.nr.682/2024 të datës 16.07.2024 ka refuzuar si të pabazuara ankesat e mbrojtësve av.A.A., dhe av.A.M., për caktimin e masës së paraburgimit dhe ka vertetuar aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prizren. Me datë 30.07.2024 PTHPZ —DKR, ka parashtruar kërkesën për vazhdimin e masës së paraburgimit ndaj të pandehurve të lartcekur, ku gjykata me aktvendimin Ppr.Kr.nr.64/24 të datës 06.08.2024 ka vazhduar masën e paraburgimit ndaj dy të pandehurve në kohëzgjatje prej I (një) muaj, respektivisht deri me datë 07.09.2024. Ndaj këtij aktvendimi, me date 09.08.2024 mbrojtësi i të pandehurit E.A., av.A.A., ka ushtruar ankesë, të cilën Gjykata e Apelit me aktvendimin PN I .DKR.nr.813/2024 të datës 16.08.2024 e ka refuzuar si të pabazuar. Mbrojtësja e të pandehurit H.B., av.A.M., me datë 05.08.2024 është drejtuar me urgjencë gjyqtares së procedurës paraprake lidhur me ankesën për ligjshmërinë e paraburgimit. Gjyqtarja e procedurës paraprake me datë 22.08.2024, me shkresë e ka njoftuar avokaten mbrojtëse se deri në këtë fazë asgjë nuk ka ndryshuar lidhur me pretendimet e mbrojtjes për ndërprerjen e paraburgimit, po ashtu ende ekzistojnë arsyet për të cilat është vazhduar paraburgimi dhe se nuk janë përmbushur kushtet ligjore për abrogimin e paraburgimit. PTHPZ — DKR me datë 03.09.2024 ka parashtruar kërkesën për vazhdimin e masës së paraburgimit ndaj të pandehurve të lartcekur, ku gjykata me aktvendimin Ppr.Kr.nr.64/24 të datës 05.09.2024 ka vazhduar masën e paraburgimit ndaj dy të pandehurve në kohëzgjatje prej I (një) muaj, respektivisht deri me datë 07.10.2024. Ndaj këtij aktvendimi, me datë 09.09.2024 mbrojtësja e të pandehurit H.B., av.A.M., ka parashtruar ankesë.

Sa i përket pretendimeve të cekura në ankesën e av.A.M., ndaj gjyqtares A.S., për shkelje disiplinore, sa i përket vlerësimit të ligjshmërisë së paraburgimit, Kryetarja konstaton se janë të pabazuara pasi që me dispozitën e nenit 189 par.4 të KPPRK-së parashihet se "Nëse i pandehuri ankohet për ligjshmërinë e paraburgimit, gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trripit gjykues mund të zbatojë seancë dëgjimore në pajtim me neni 185, paragrafët 3, 4, 5 dhe 6 të këtij Kodi nëse në shikim të parë me ankesë vërtetohet se: 4.1. arsyet për paraburgim nga neni 184 i këtij Kodi që nga vendimi i fundit gjyqësor për paraburgim pushojnë së ekzistuari për shkak të ndryshimit të rrethanave ose zbulimit të fakteve të reja; ose 4.2. ndalimi për ndonjë arsye tjetër është i kundërligjshëm.", në rastin konkret rezulton se caktimi i seancës dëgjimore lidhur me ligjshmërinë e paraburgimit nuk është obligative por varet nga rrethanat e rastit konkret dhe aq më tepër gjyqtarja e procedurës paraprake me date 22.08.2024, e ka njoftuar me shkrim avokaten në fjalë lidhur me ankesën për ligjshmërinë e paraburgimit duke theksuar që për momentin nuk kanë ndryshuar rrethanat për ndërprerjen e masës së paraburgimit.

Andaj, si Autoritet Kompetent bazuar në të lartcekura konsideron se gjyqtarja A.S., me veprimet e saj nuk ka pasur shkelje të cilat konsistojnë me shkeljet disiplinore të parapara me nenin 5 të Ligjit për Përgjegjësinë disiplinore të Gjyqtareve dhe Prokurorëve ku është paraparë shkelje sa i përket sjelljes, qoftë kur është në detyrë apo privatisht, të cilat dëmtojnë reputacionin e gjykatës ose mund të dëmtojnë besimin e publikut në paanshmërinë ose besueshmërinë e gjyqësorit.

Për arsyet e cekura më lartë, Autoriteti Kompetent — Kryetarja e Gjykatës ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit në kuptim të nenit 9 paragrafi 6 lidhur me nenin 17 paragrafi 5 të Ligjit nr.06/L-057 për përgjegjësinë disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

AD-GJTHPZ.nr.12/2024, me dt.30.09.2024

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prizren

14
✓
Shpresa Emra
e paraparë e drejta e ankesës.

The image shows an official blue stamp of the Prizren District Court. The stamp is circular and contains the text 'REPUBLIKA E KOSOVES' at the top, 'GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN' in the middle, and 'KRYETARJA E GJYKATËS' at the bottom. A handwritten signature in blue ink is written over the stamp. To the left of the stamp, the number '14' is written, and a checkmark is placed below it. Below the signature, the text 'Shpresa Emra' and 'e paraparë e drejta e ankesës.' is written.

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e paraparë e drejta e ankesës.